

V E N D I M
Nr.4, datë 27.2.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Zija Vuci	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 5.2.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.5 Akti që i përket:

KËRKUESI: RAHMI ÇOÇKA, përfaqësuar nga avokat Sotiraq Ceta, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga zoti Skënder Breca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese i vendimeve nr.59, datë 4.3.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr.57, datë 30.4.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe nr.584, datë 25.10.2002 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore:

- Prokuroria dhe gjykatat nuk kanë zhvilluar një hetim ligjor të plotë e objektiv në përputhje me kërkesat e nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale;
- Gjykatat nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë, parashikuar në nenin 30 të Kushtetutës dhe në nenin 6/2 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut;
- Është cenuar parimi i barazisë së mjeteve, sepse nuk janë verifikuar pretendimet e mbrojtjes;
- Në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës është deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.59, datë 4.3.2002, ka deklaruar fajtor kërkuesin Rahmi Çoçka për krimin e vrasjes me paramendim parashikuar nga neni 78/1 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 19 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) me vendimin nr.584, datë 25.10.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton elemente të një procesi jo të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Çështja është dërguar për gjykim me kërkesën e prokurorisë me akuzën e vrasjes me paramendim sipas nenit 78/1 të Kodit Penal. Gjykata e rrethit ka administruar në gjykim provat e paraqitura jo vetëm nga prokurori, por edhe nga mbrojtja, duke bërë vlerësimin e tyre. Ajo ka dëgjuar në seancë të rregullt dëshmitarët për momentet e pretenduara nga akuza e mbrojtja dhe në përfundim ka konkluduar në fajësinë e të pandehurit. Përsa i përket pretendimeve të ngritura për provueshmërinë,

ato janë në kompetencën ekskluzive të gjykatave të sistemit gjyqësor dhe nuk janë çështje të juridiksionit kushtetues.

Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë paragjykuar çështjen duke shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë.

Prezumimi i pafajësisë është një parim kushtetues i parashikuar në nenin 30 të Kushtetutës dhe përbën një ndër elementet thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim nënkupton para së gjithash që gjyqtarët të mos e gjykojnë çështjen me bindjen se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Në çështjen në gjykim, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton që gjykatat e rrethit dhe apelit të jenë prononcuar për fajësinë para se ato të vlerësonin provat në gjykim dhe as i kanë mohuar kërkuesit ushtrimin e së drejtës për të paraqitur provat e veta e për të kundërshtuar ato të akuzës.

Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së mjeteve, rezultoi se gjykatat nuk i kanë vënë palët në pozita të pabarabarta. Ato i kanë administruar provat e paraqitura prej këtyre të fundit. Gjykata e rrethit i ka pyetur drejtpërdrejt dëshmitarët në gjyq dhe ka lexuar sipas rastit thëniet e tyre në prokurori. Leximi i këtyre thënieve në gjykatë nuk përbën në vetvete element të procesit jo të rregullt përderisa gjykata ka respektuar njëkohësisht të drejtat e mbrojtjes për të parashtruar kundërshtimet rreth këtyre dëshmimeve. Në përfundim të këtij hetimi gjyqësor, gjykata e ka vlerësuar si të panevojshme edhe kërkesën e avokatit për zhvillimin e një eksperimenti hetimor për mundësinë e vështirimit të ngjarjes. Mospranimi i kësaj kërkeje në çështjen në shqyrtim nuk cenon parimin e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, aq më tepër që, gjykatat në vendimet e tyre, nuk i kanë pranuar këto dëshmi si prova për fajësinë e të pandehurit.

Kërkuesi pretendon gjithashtu se ai është deklaruar fajtor në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës, mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Sipas kërkuesit, dëshmitarët e mitur janë mbajtur në polici për 24 orë dhe kanë firmosur në procesverbale pa qenë të vetëdijshëm se çfarë ishte shkruar në to.

Nga dosja gjyqësore nuk vërtetohet që deklaratimet e dëshmitarëve të jenë marrë me mënyra e metoda të paligjshme. Dëshmitarët e mitur janë pyetur në prani të mësuesit apo të prindit. Për më tepër, në gjykim, ata kanë ndryshuar thëniet e kanë deklaruar të kundërtën, sikur nuk e kanë parë ngjarjen dhe përfundimisht gjykata thëniet e tyre nuk i ka vlerësuar si prova kundër të pandehurit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi për pranimin e kërkesës.

Kërkuesi Rahmi Çoçka, pretendon se në shqyrtimin e çështjes së tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Apelit Korçë nuk kanë respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin e barazisë së armëve.

Çështja penale për vrasje me paramendim, në ngarkim të kërkuesit, është dërguar për gjykim me kërkesë të prokurorisë, bazuar në dëshminë e të miturit Arif Guri. Ai është dëshmitari i vetëm okular që ka parë ngjarjen dhe përbën provën e vetme direkte të çështjes. Çështja bazohet edhe në provat indirekte (indiciet) që janë dëshmitë e nënës, gruas dhe vëllait të viktimës, të cilët kanë deklaruar se një javë para ngjarjes, viktimë është rrahur prej kërkuesit dhe është kanosur për vrasje.

Nga vendimet gjyqësore del se pesha e provës në proces nuk ka rënduar mbi akuzën. Ky qëndrim të çon në konkluzionin se gjyqtarët e kanë gjykuar çështjen me bindjen se i akuzuari e ka kryer veprën penale. Në këtë mënyrë është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë parashikuar në nenin 30 të Kushtetutës e nenit 6/2 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Lidhja midis provave direkte dhe indirekte është ndërprerë gjatë gjykimit të çështjes, pasi në seancë gjyqësore, dëshmitari i mësipërm mohoi ta ketë parë ngjarjen. Pavarësisht nga kjo gjendje e re e provave, gjykata e deklaroi kërkuesin fajtor, duke pranuar kryerjen e veprës penale sipas dëshmisë së dëshmitarit Arif Guri dhe mbështetur në dëshminë e familjarëve të tij.

Nga materialet e çështjes rezulton, se gjykata nuk ka pranuar kërkesën e avokatit të kërkuesit për kryerjen e një ekspertimi hetimor pamor për të verifikuar mundësinë e vështirimit të ngjarjes sipas dëshmisë së Arif Gurit. Ajo ka injoruar provat e administruara lidhur me alibinë e pretenduar prej kërkuesit duke mos i përmendur fare në arsyetimin e vendimit të saj.

Rastet kur prej gjykatës njëra palë vihet në pozitë të disfavorshme në raport me palën tjetër, si dhe kur kjo gjendje pabarazie shfaqet me vlerësimin e provave të njëres palë dhe mosvlerësimin e provave dhe të kërkesave të palës tjetër, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6/2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Për çështjen në shqyrtim, gjykatat nuk kanë respektuar parimet e mësipërme, sepse ato, pa asnjë shkak të motivuar, nuk kanë verifikuar pretendimet e mbrojtjes për kryerjen e eksperimentit hetimor, si dhe nuk kanë bërë verifikimin e vlerësimin e provave të administruara lidhur me alibinë.

Ekzistenca e shkeljeve të mësipërme, të dala nga materialet e çështjes, flet për proces të parregullt ligjor, çka i bën vendimet e gjykatave antikushetuese.

Është detyrë e gjykatave të zakonshme që vendimin e tyre ta mbështesin në fakte e prova që sjellin palët, por duke i analizuar dhe arsyetuar ato në bazë të ligjit dhe me objektivitet. Në rastin në shqyrtim, vendimet e gjykatave janë marrë vetëm me pretendimet dhe provat e akuzës dhe nuk kanë shqyrtuar e analizuar me objektivitet pretendimet dhe provat e kërkuara nga mbrojtja e kërkuesit.

Anëtarë: K. Puto, Z. Vuci, Gj. Sauli